**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**Nr. Rep. [...]** 2478
**Nr. Kol. [...]** 1011

REPUBLIKA E SHQIPERISE ARJANA MALLKUCI NOTERE TIRANE

## KONTRATE TRANSFERIMI AKSIONESH

Sot me date 25.04.2007, ne Tirane perpara meje Arjana Mallkuci, Notere e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:

**Nga njera ane:**

1. **Shyqyri DURAKU**, shtetas shqiptar, lindur më 8 Dhjetor 1954, në Kukës, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr.0012023, lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme më datë 27 Nëntor 2001, e vlefshme deri më datë 27 Nëntor 2006.
2. **Llazar ANGJELI**, shtetas shqiptar, lindur më 5 Shkurt 1940, në Sarandë, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr. Z0085140, lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme më datë 12 Qershor 2002, e vlefshme deri më datë 11 Qershor 2012.
3. **Avni PONARI**, shtetas shqiptar, lindur më 28 Korrik 1957, në Tropojë, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr. Z1252170, lëshuar nga Ministria e Rendit Publik, më datë 8 Nëntor 2004, e vlefshme deri më datë 7 Nëntor 2014.
4. **Edvin HOXHAJ**, shtetas shqiptar, lindur më 30 Prill 1966, në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr. 1247470, lëshuar nga Ministria e Rendit Publik, më datë 12 Mars 2005, e vlefshme deri më datë 11 Mars 2015.
5. **Albanian-American Enterprise Fund "AAEF"**, shoqëri jofitimprurëse e themeluar sipas së drejtës amerikane, (shteti Delaware), me seli në New York, e përfaqësuar ligjërisht nga z. Jeffrey Griffin, shtetas amerikan, lindur ne Georgia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 14 Qershor 1944, rezident në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Amerikane Nr. 10333338, lëshuar më 12 Korrik 2003, e vlefshme deri më 17 Korrik 2013, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm;

(se bashku quajtur ketu e me poshte si **"Aksionaret e SIGAL Sh.A."**)

**dhe**

**Nga ana tjeter**

**SIGAL Holding SH.A.** nje shoqëri anonime e regjistruar si person juridik në bazë të Vendimit Nr. 37818, datë 21.03.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me seli në adresen Bulevardi "Zogu I", Pallati i Diplomateve, nr. 57, Tiranë, Shqipëri. dhe ne reference me Vendimin e Asamblese se shoqerise date 17. 04.2007 bashkengjitur si Aneks 1 kesaj Kontrate.

(ketu e me poshte i quajtur si **"Bleresi"**)

**Pasi studiova dokumentacionin e paraqitur drejteperdrejt nga Palet ose nga perfaqesuesit e tyre, vertetoj se Palet dhe perfaqesuesit e tyre kane zotesi te plote juridike per te vepruar si dhe aftesi per te lidhur kete Kontrate. Ne perputhje me vullnetin e tyre te lire Palet me kerkuan te perpiloj kete Kontrate me kushtet e meposhtme:**

## 1. HYRJE

**Duke pasur parasysh se** Aksionaret e shoqerise SIGAL Sh.A zoterojne bashkerisht 100% te kapitalit te nenshkruar dhe te gjithe te drejtat e votes ne shoqerine SIGURACIONI SHQIPTAR- SIGAL SH.A., nje shoqeri anonime sigurimesh e krijuar dhe e regjistruar ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise me Vendimin Nr. 20863 date 22.02.1999 te Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane, mbajtes te Autorizimit Nr. 2 date 23.06.1996, dhe Vendimit Nr. 6, date 03.02.2006 te leshuar nga Keshilli Mbikeqyres i Autoritetit te Sigurimeve me seli ne Bulevardi Zogu I, Nr.1, Tirane, Shqiperi, "ketu e me poshte referuar si SIGAL Sh.A." me kapital fillestar 400.000.00 Leke i ndare ne 121,212 aksione me vlere nominale 3,300Leke secili.

**Duke pasur parasysh se** objekti i aktivitetit te Bleresit eshte mbajtja e biznesit, koordinimi dhe menaxhimi i interesave te Aksionareve te shoqerise SIGAL Sh.A

**Duke pasur parasysh se** Aksionaret e shoqerise SIGAL Sh.A. jane gjithashtu aksionaret e Bleresit me pjesemarrje si me poshte:

- Avni PONARI zoteron 45.01% te kapitalit te shoqerise SIGAL HOLDING SH.A. ose 9,002.00 aksione me vlere 900,200.00 Leke.
- Llazar ANGJELI zoteron 26.01% te kapitalit te shoqerise SIGAL HOLDING SH.A ose 5,202.00 aksione me vlere 520,200.00 Leke.
- Shyqyri DURAKU zoteron 9.61% te kapitalit te shoqerise SIGAL HOLDING SH.A ose 1,922.00 aksione me vlere 192,200.00 Leks.
- Edvin HOXHAJ zoteron 6.07% te kapitalit te shoqerise SIGAL HOLDING SH.A ose 1,214.00 aksione me vlere 121,400.00 Leks.
- Albanian-American Enterprise Fund zoteron 13.30 % te kapitalit te shoqerise SIGAL HOLDING SH.A ose 2,660.00 aksione me vlere 266,000.00 Leks.

**Duke pasur parasysh** se aksionaret e shoqerise Sigal Sh.A. deshirojne te transferojne nepermjet shitjes te gjithe paketat aksionare te Bleresi dhe ky i fundit pranon transferimin e gjithe numrit te aksioneve qe secili Aksionar ka sipas parashikimeve te kesaj Kontrate.

Per sa me siper, Palet rane dakord sa me poshte:

2.2 Cdo Aksionar do te transferoje nepermjet shitjes ate numer te Aksioneve te Shoqerise te percaktuar perbri emrit te secilit ne tabelen e meposhtme. (ku numer aksionesh do te referohet si "**Aksionet e Transferuara**".

| Emri | Numri i aksion-eve te Aksion-areve te SIGAL SH.A. | ne % | Aksionet e Trans-feruara | Vlera nomi-nale e secilit aksion |
|---|---|---|---|---|
| Avni PONARI | 55,078 | 45,44 | 55,078 | |
| Edvin Hoxhaj | 7,467 | 6,16 | 7,467 | |
| Shyqyri Duraku | 12,122 | 10,40 | 12,122 | |
| Llazar ANGJELI | 32,000 | 26,40 | 32,000 | |
| AAEF | 14,545 | 12,00 | 14,545 | |
| Totali | 400,000,000 | 100,00 | 121.212 | 3,300 |

2.3 Aksionaret do te shesin Aksionet e Transferuara te Shoqerise me vlere nominale tek Bleresi i cili i pranon.

2.4 Transferimi i pjesëve të kapitalit ka efekt te menjëhershërm me nenshkrimin e kesaj Kontrate. Bleresi është mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve të tilla si pjesëmarrja në fitime duke filluar nga viti ushtrimor perkatës.

## 3. GARANCI TE BLERESIT

Bleresi garanton se:

a) Eshte nje shoqeri e krijuar dhe qe vepron ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise.
b) Ka fuqine dhe autoritetin per te hyre ne kete Kontrate.

## 4. GARANCI DHE ZOTIME TE AKSIONAREVE TE SIGAL SH.A.

4.1 Cdo Aksionar i SIGAL Sh.A. garanton se:

a) Ka fuqine autoritetin dhe aftesine ligjore per te hyre ne kete Kontrate.

b) Gezon te drejten e plote te pronesise mbi Aksionet e Transferuara, te cilat transferohen nepermjet shitjesit tek Bleresi te lira nga cdo barre, hipoteke apo mjet tjeter per sigurimin ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

c) Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Aksionaret e SIGAL Sh.A. heqin dore nga pronesia mbi Aksionet e Transferuara dhe zoterues i vetem e i ligjshem, me te drejta dhe detyrime te plota mbi Aksionet e Transferuara do te jete Bleresi, i cili i pranon.

2.2 Cdo Aksionar do te transferoje nepermjet shitjes ate numer te Aksioneve te Shoqerise te percaktuar perbri emrit te secilit ne tabelen e meposhtme. (ku numer aksionesh do te referohet si "**Aksionet e Transferuara**".

| Emri | Numri i aksion-eve te Aksion-areve te SIGAL SH.A. | ne % | Aksionet e Trans-feruara | Vlera nomi-nale e secilit aksion |
|---|---|---|---|---|
| Avni PONARI | 55,078 | 45,44 | 35,200 | |
| Edvin Hoxhaj | 7,467 | 6,16 | 7,467 | |
| Shyqyri Duraku | 12,122 | 10,40 | 32,000 | |
| Llazar ANGJELI | 32,000 | 26,40 | 32,000 | |
| AAEF | 14,545 | 12,00 | 14,545 | |
| Totali | ~~400,000,000~~ 121,212 | 100,00 | 121.212 | 3,300 |

2.3 Aksionaret do te shesin Aksionet e Transferuara te Shoqerise me vlere nominale tek Bleresi i cili i pranon.

2.4 Transferimi i pjesëve të kapitalit ka efekt te menjëhershërm me nenshkrimin e kesaj Kontrate. Bleresi është mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve të tilla si pjesëmarrja në fitime duke filluar nga viti ushtrimor perkatës.

## 3. GARANCI TE BLERESIT

Bleresi garanton se:

a) Eshte nje shoqeri e krijuar dhe qe vepron ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise.
b) Ka fuqine dhe autoritetin per te hyre ne kete Kontrate.

## 4. GARANCI DHE ZOTIME TE AKSIONAREVE TE SIGAL SH.A.

4.1 Cdo Aksionar i SIGAL Sh.A. garanton se:

a) Ka fuqine autoritetin dhe aftesine ligjore per te hyre ne kete Kontrate.

b) Gezon te drejten e plote te pronesise mbi Aksionet e Transferuara, te cilat transferohen nepermjet shitjesit tek Bleresi te lira nga cdo barre, hipoteke apo mjet tjeter per sigurimin ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

c) Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Aksionaret e SIGAL Sh.A. heqin dore nga pronesia mbi Aksionet e Transferuara dhe zoterues i vetem e i ligjshem, me te drejta dhe detyrime te plota mbi Aksionet e Transferuara do te jete Bleresi, i cili i pranon.

d) Kjo Kontrate perben nje detyrim te ligjshem dhe te zbatueshem per cdo Aksionar kundrejt cdo Aksionari tjeter te SIGAL ShA. ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate.

4.2 Aksionaret marrin persiper te pergatisin dhe te regjistrojne kete Kontrate dhe vendimet perkatese te Mbledhjeve te Asambleve te Aksionareve te paleve dhe te Keshillit Mbikeqyres te Sigal Sh.A se bashku me nje kerkese per regjistrimin e kesaj Kontrate me Regjistrin e Shoqerive Tregtare prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane pas lidhjes se kesaj Kontrate si dhe te ndermarrin cdo hap qe do te jete i nevojshem ose i keshillueshem me qellim qe te pajise Bleresin me titull te plote, te pavesuar, te ligjshem ne lidhje me aksionet e transferuara nepermjet shitjes.

## 5. LIGJI ZBATUES

Kjo Kontrate dhe marredheniet midis Paleve do te rregullohen dhe interpretohen ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise.

## 6. JURIDIKSIONI

Cdo mosmarreveshje qe do te linde nga ose ne lidhje me kete Kontrate do ti nenshtrohet gjykimit te gjykatave kompetente shqiptare.

## 7. TE NDRYSHME

### 8.1 Teresia e Kontrates

Kjo Kontrate perben teresine e saj dhe mirekuptimin midis Paleve ne lidhje me objektin e kesaj Kontrate.

### 8.2 Ndryshime, Modifikime

Asnje ndryshim, variacion apo modifikim i kesaj Kontrate nuk dote jete i vlefshem pervec rastit kur do te behet me shkrim, i regjistruar ne nje dokument te vetem nga ose ne emer te cdo Pale.

## 8. GJUHA/KOPJET

Kjo Kontratë është hartuar në 8 ekzemplarë në gjuhën Shqipe me të njëjtën vlerë ligjore.

**Aneks 1**
Vendimi i Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR-SIGAL Sh.A. date 17. 04.2007.

**Aneks 2**
Vendimi i Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise SIGAL HOLDING SH.A. date 17. 04.2007.

**Aneks 3**

Vendimi i Keshillit Mbikeqyres i Shoqerise Sigal ShA. 17.04.2007

Unë, noterja, pasi u binda për identitetin e palëve dhe aftësinë e tyre për të vepruar dhe pasi ua lexova përmbajtjen e kësaj kontrate me zë të lartë, në prani të perkthyeses se gjuhes angleze Sofika Rapi konstatova se ajo vinte në perputhje me qëllimin e tyre dhe pasi ata e nënshkruan atë rregullisht përpara meje, vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

<u>AKSIONARET E SHOQERISE SIGURACIONI SHQIPTAR- SIGAL SH.A</u>

Avni PONARI

Llazar ANGJELI

Edvin HOXHAJ

Shyqyri DURAKU

Fondi Shqiptaro- Amerikan i Ndermarrjeve

Perfaqesuar nga

Jeffrey T. Griffin

FONDI SHQIPTARO AMERIKAN I NDERMARRJEVE TIRANE ALBANIA

<u>BLERESI</u>

SIGAL HOLDING SH.A.

Perfaqesuar nga

AVNI PONARI

NOTER

Përkthen: Sofika Rapi